


**CFARE DUHET TE DINI**

**TE MERRNI TE RUANI PATENTEN  
E SHOFERIT NE IOWA OSE LEJEN**



**ALBANIAN STUDY GUIDE**

## Shenjat dhe sinjalet

### Ndjyrat standarde

Format dhe ngjyrat ne shenjat e autostradave kane kuptime te vecanta. Kjo ju ndihmon ju te dalloni shenjat me nje te pare.

- **E KUQE:** ndalon ose pengon
- **E GJELBERT:** jep drejtimin
- **E KALTERT:** tregon ku ka sherbime ngasesish shoferesh
- **E VERDHE:** paralajmerim
- **E BARDHE:** rregullore
- **PORTOKALLI:** ndertime ose mirembajtje
- **KAFE:** qendra kulturore dhe shlodhjeje.

### Format standarte



#### Tetekendeshi ( I kuq ) stop

Te kjo shenje ndualuni teresisht, perpara keni rruge kembesoresh ose kthese para se te kryqezim. Lejoni t' ju parakalojne ato makina qe kane hyre tashme ne kryqezim apo jane aq afer sa ne se I kaloni ju ato, do te krijoni nje situatë te rrezikshme.



#### Trekendeshi barabrinjes ( Ikuq ) lejo

Ngadaleso dhe lejo parakalim te gjithë makinave ne rrugen tuaj. Ne se duhet ndaloni para se te hyni ne rruge kalimi apo kryqezim.



#### Ndalim kalimi

Gjendet ne anen majte te rruges paralajmeron ndalim kalimi.



#### Rombi ( Iverdhe ) paralajmerim

Para jush ka disa rreziqe. Me vone do t' u behet e ditur cfare rreziqesh me fjale apo simbole, se pse duhet te ndaloni ose te keni kujdes me shume se zakonisht.

## Format standarte



#### Katrori ( I bardhe ) rregullore ose udhezues

Shenjat vertikale ndalojne ose kerkojne dicka nga ju. Horizontalet jane informative, japin drejtime te ndryshme ose tregojne sherbime per motoristet.



#### Pesekendeshi ( I verdhe ) kryqezim para nje shkolle

Keto shenja paralajmerojne e tregojne vendet ku ka shkolle.



#### Rrethi ( I verdhe ) kalim mbi shina treni

Kjo shenje ju tregon qe keni shina treni perpara jush.



#### Kryqi ( I bardhe )

Perdoret aty ku jane shinat e trenit.

## Lajmerimet

Ketu jane disa shembuj shenjash paralajmeruese. Ato ju tregojne per rreziqe te mundeshme para seju t' i shihni ato.



### Bashkim

Nese ju jeni ne rruge kryesore dhe shihni kete shenje, makinat tjera duhet t' ju lejojne ju ti parakaloni.



### Dy rruge kalimi

Mbani anen E djathte se po lini nje rruge nje kalimshe, dhe po hyni ne nje rruge me dy kalime.



### Ndarja e rruges mbaron

Shiko per makina qe vine shoferet e tjere mund te mos e kene para shenjen anash.



### Jepni perparesi kalimi anes se majte

Dy ripa se shpejti do te behen nje. Komunikacioni l anes se djathte duhet ti jepe perparsi kumunikacionit se anes se majte te drejtimin te njejte.



### Ndarje rruge

Jeni afer pikes ku dy rruge kalimi po ndahen nga nje rrip ne mes.



### Limiti I shpejtesise

Maksimumi I shpejtesise ne dalje.

## Rregulloret



### Rruge e gabuar

Jeni kthyer gabim dhe keni hyre kunder rrymes. Korrigjoni gabimin ne menyren me te parrezikshme.



### Rrini djathtas

Rruga para jush do te ndahet. Rrini djathtas ishullit apo pengeses se krijuar.



### Mos hyni

Rrini larg cdo rruge me kete shenje.



### Nje kalim

Kalimi rrjedh vetem ne drejtimin e treguar me shigjete.



### Jo kthese majtas

Perdoret ne afersi te kryqezimeve ku ndalohen kthesat majtas.



## Rregullore



**Stop**  
Ndalo krejtësisht.



**Lejo**  
Duhet të ndaloni dhe të lejoni të tjeret para jush.



**Kufiri I shpejtësisë 40**  
Ky është maksimumi i shpejtësisë me të cilën mund të udhëtoni në kushte ideale aty ku do të jetë kjo shenjë.



**Makina qe ecin ngadale**  
Makinat që terheqin kafshe dhe ato që janë si traktore e pajisje fermash të paracaktuara për të levizur jashtë autostradave dhe që ecin me shpejtësi 25 mph ose më pak, duhet të kenë këtë shenjë. Është aq e madhe sa të shihet nga një distancë 500 këmbesh dhe është trekëndësh portokalli i rrethuar me shirit të kuq.

## Shenja ne asfalt

Sikurse shenjat e autostradave, shenjat mbi asfalte ndihmojnë kalimin. Ju do t' i shihni ato vetëm ose të shoqëruara me shenja e simbole.

Vizat e bardha ndajnë kalimin në të njëjtin drejtim, kurse vizat e verdha, kalimin në drejtime të ndryshme. Në se qendra e vizes është e panderprere, rritni në anën tuaj. Në rruget dy drejtimesh ju do të shihni shpesh një vize të panderprere dhe një të ndreprete pranë njëra-tjetres. Nuk lejohet të ndërrojnë anë makinat nga ana e vizes së panderprere, por makinat nga ana e vizes së ndreprete mund të kalojnë kur rruga është e lire.

Në kryqezime dhe në kalime mbi shina treni, disa shenja speciale, rregullore ose viza të forta të bardha do t' ju tregojnë drejtimin ose vendet ku kalojnë kalimtarët.



Vizat e bardha  
Vizat e bardha ndajnë kalimin në të njëjtin drejtim.




Vizat e verdha  
Vizat e verdha ndajnë kalimin në drejtime të ndryshme.

## Drita kalimi

### E kuqe

Ndaluni krejtësisht tek viza e shënuar për këtë para se të hyni në kryqezim ose në kalim këmbësorësh. Kthesat djathtas lejohen me përjashtim të rasteve kur ka shenjë të posaçme që e ndalon këtë. Kur merrni kthesat djathtas në dritë të kuqe, duhet të prisni sa të kalojnë të gjitha makinat dhe rruga të jetë e lire, ndërsa ju prisni i ndaluar në vend. Në se jeni në një rrugë me një kalim ju mund të merrni këthese majtas pasi keni ndaluar me para dhe të hyni në një rrugë tjetër me një kalim, me përjashtim të rasteve kur ka shenjë të posaçme që e ndalon këtë këthese. Kthesat e bera pasi ndalon në dritë të kuqe, nuk duhet të interferojnë me këmbësorët apo makinat e tjera në kryqezim.



### E verdhe

Mos hyni në kryqezim pa u ndaluar me parë nëse mundeni. Nëse nuk mund të ndaloni dot në kohë, vazhdoni rrugën me kujdes përmes kryqezimit. Shpejtësia që keni dhe largësia që keni nga sinjali do të përcaktojnë nëse mund të kaloni apo jo. Një dritë e verdhe gjithashtu do t' u tregojë këmbësorëve se nuk kanë kohë të mjaftueshme për të kaluar kryqezimin dhe se çdo këmbësor duhet t' u lere rrugë makinave të kalojnë.

### E gjelbert

Kaloni vetëm nëse ka këmbësorë në rrugën tuaj. Lejoni të kalojnë me parë të gjithë këmbësorët dhe makinat në kryqezim. Kur ndryshon drita, ata që

## Shigjete e gjelbert

Kaloni vetem ne drejtimin e shigjetes. Lejo te kalojne kembesoret dhe makinat e tjera ne kryqezim.



### E kuqe qe pulson

Ndaloni dhe lejoni makinat e kembesoret pastaj vazhdoni rrugen kur eshte e lire.



### E verdhe qe pulson

Ecni me kujdes

## Shenja me duar

Para cdo kthese qe merrni, sinjalizoni me duar apo me dritat e makines. Kjo u tregon shofereve te tjere, para apo pas jush se cfare doni te beni. Ju duhet te sinjalizoni te pakten 100 feet ( kembe ) para se te ktheheni nese po ecni me 45 mph ose pak dhe 300 feet ( kembe ) para nese po ecni me shume se 45 mph. Per shkak te kohes per veprim dhe shpejtesie, sinjalalizoni me shpejt kur ecni me shpejt.

## Manovrimet

Ta zeme se keni marre patenten dhe keni makinën tuaj me vete. Ajo qe ju duhet tani eshte rruga e madhe dhe aftesia per te marre vendime me shpejtesi. Duke e ngasur makinën nga ju kerkohen afro 20 vendime te rendesishme ne cdo milje rruge. Pra cesesi per te manovruar mire makinën tuaj eshte njohja e rregullave te rruges, te qenit te vemendshem dhe parashikimi i levizjeve te shofereve te tjere. Sigurisht, eksperienca eshte e rendesishme por kete mund ta fitoni me kalimin e viteve ne praktikim makine dhe marrje vendimesh te drejta. Kyci i mbijeteses eshte te dish c' duhet te besh dhe kur duhet ta besh. Krahasoni aftesite tuaja me keto manovra teknike.

### Mbrapa

Mos u mbeshtet tek pasqyrat. Me doren e majte mbi timon ktheje trupin e koken djathtas / majtas dhe shih pas vets. Rrotullo timonin ne ate drejtim ku desheron te veje fundi i makines dhe ec mbrapsht ngadale. Gjithmone lejo te kalojne kembesoret dhe makinat trouar ose rruge.

kalojne mund te ngelen ne mes te rruges ndaj ju duhet t' u jepni kohe sa te kalojne.

### Parkimi

Kur ju e ndalni makinën ne te tatepjete, ktheni rrotat e makines nga ana e ktheses ose e rruges. Nese jeni ne te perpjete, ktheni rrotat e para nga ana tjeter e ktheses, lereni makinën te shkoje mbrapsht derisa rrota e djathte perpara takon anen e rruges. Ne se po parkon ne te perpjete ku s' ka kthese, ktheni rrotat e para nga ana e rruges.

### Parkimi paralel

1. Sinjalizo, ndalo barabar me makinën tjeter dhe rreth 18 inc ( gati gjysme metri ) larg saj.
2. Jepi mbrapsht ngadale duke kthyer timonin djathtas dhe shko pas makines tjeter.
3. Kur makina juaj eshte e vendosur mire pas makines tjeter, jepi timonit majtas shume derisa makina juaj gati ta takoje tjetren pas.
4. Jepi timonit djathtas shume dhe vendose makinën tende ne mes te vendit te parkimit. Rrotat tuaja duhet te jene 18 inc ( gatigjysme metri ) nga ana e rruges .

Kjo qe per parkimet djathtas, kur do parkoni majtas ne nje rruge me nje kalim, permbysni gjithë "djathtas" ne "majtas" me lart. Pasi parkoni, fikni motorin dhe hiqni celesat. Eshte e denueshme nga ligji te mbani motorin ndezur ne nje makine te parkuar qe s' ka njeri brenda. Gjithnje perdor frenat e urgjences. Kjo mbron makinën nga shtyrja ne rruge kur goditet nga pas. Nese makina juaj ka marshe automatike, vure ne "park" para se te ikni. Per marshet manuale, lereni makinën ne marshin e ulet kur parkoni ne te perpjete dhe ne te kundert kur jeni ne te tatepjete. Per te ikur nga parkimi sinjalizoni, shikoni per trafik, ktheni timonin dhe lejoni te parakalojne makinat qe po vine. Kur gjeni nje mundesi, dilni jashte dhe hyni ne trafik. Kur parkoni prane nje rruge jashte qytetit te kater rrotat duhet te jene jashte rruges. Ne cdo rast parkimi ilegal, policia eshte e urdheruar t' i levizi makinat.

### Parkimi nuk lejohet

- Ne nje kryqezim:
- Para nje daljeje nga vende private apo publike:
- Ne cdo ure jashte qytetit dhe tunel autostrade:
- Paralel nje makine tjeter te parkuar:
- 5 kembe nga impiantet e zjarrefikesve:
- 10 kembe nga shenja "stop":
- 20 kembe nga hyrja ne nje stacion zjarrefikesish:
- 50 kembe nga hyrja e nje teatri ose hoteli:
- 50 kembe nga shinat e trenit:

- Me afer se 8 kembe parallel me shinat e trenit:
- Ne vendet ku shkruhet "no parking zone" qe zakonisht jane shenja ose kthesa te bera me te verdhe:
- Ne nje kryqezimne:
- Nje trotuar:

## Distanca dy sekondeshe

Sa afer te rri? Rruga me e lehte eshte te rrini larg makines para jush ne nje distance dysekondeshe. Kjo ju jep ju largesine prej nje e gjysme makine per cdo 10 milje. Ne se kushtet e udhetimit s' jane ideale, rrisni distancen.

### Ndiqni keto rregulla per dy sekonda distance.

1. Kur makina para po kalon nje pike te caktuar, shenje, rruge makine te parkuar.
2. Fillo te numerosh sekondat kur pjesa e fundit e makines para kalon kete pike te caktuar.
3. Pusho numerimin kur makina juaj eshte te kjo pike. Ne se qe me pak se dy sekonda, rrisni distancen mes dy makinave.
4. Ne se qe me shume se dy sekonda, juve keni distance te mire me makinen para jush.

Jepini vetes shansin te mendoni perpara. Shikoni 12 sekonda perpara ne kalimet mes qytetit dhe 20-30 sekonda para per shpejtesite e medha. Kjo ju jep juve mundesine per te planifikuar veprimet tuaja.

### Distancat ndjekese

Naten mbani dritat e para ne ndricim te ulet qe te mos besdisni ose ngaterroni shoferin para jush me reflekset dhe hijet. Gjithnje perdorni ndricimin e ulet kur udhet oni ne 200 deri 500 kembe largesi nga makina para. Jashte zonave te banuara dhe qendrave te punes, asnje kamion ose makine terheqese nuk duhet te ndjeki makinat e ngjashme me veten me afer se 300 kembe largesi. Rrini te pakten 500 kembe pas makinave me shenja alarmi qe kane urgjence.


### Ndjekesit

Ndjekjet mund te behen shume problematike ne disa raste. Ne se pasqyra e pasme juaja tregon se nje makine tjeter eshte shume afer jush, ky eshte shofer i pakujdesshem. Gjithese mbani largesi normale nga makina qe keni perpara.

### Ne se ju ndjekin


1. Ndiz dritat e frenimit dhe ndoshta ndjekesi terhiqet. ( Kjo varet nga distanca qe keni mes jush. Ne se eshte shume afer, frenimi mund te beje aksident ).
2. Ngadaleso dhe bej qe ndjekesi te kaloje perpara.
3. Ne se keto deshtojne, ndaloni fare dhe lini ndjekesin te kaloje. Mbani dyert e mbylluar mire gjate gjithë kohes.

### Kthesat e sakta



### Kthesa djathtas

1. Pasi shihni pas dhe sinjalizoni, levizni kater kembe larg anes se rruges, djathtas. Fillo kthesa kur rrotat e makines jane baras me cepin e rruges.
2. Ngadale hyr ne kalimin qe eshte me afer jush, asnjehere mos beni kthese te gjere.



### Kthese majtas


1. Pasi shihni pas dhe sinjalizoni, levizni ne kalimin me afer me qendren.
2. Mos l bini per shkurt. Kur doni te ktheheni majtas ne nje rruge me dy kalime, filloni kthesen kur makina juaj eshte ne mes te gjithë kryqezimit.
3. Ngadale hyr ne kalimin me djathtas me qendren.

## Kthimet

Vendosni se ku doni te ktheheni para se te mberrini ne ate vend. Ngadalesoni dhe shihni trafikun. Kurre mos beni kthese ne minuten e fundit. Eshte shume e rrezikshme. Rrini ne anen e duhur dhe gati per kthese. Gabimet me te zakonshme qe rrisin mundesine e perplasjes me makine jane kthese e gjere, te renit per shkurt ne kthese ( kthese shume e ngushte), qenia ne anen e gabuar te rruges dhe mosrespektimi i sinjavleve apo lejimi I te tjereve qe te para kalojne. Sinjalizoni te pakten 100 kembe nga kthese kur shpejtesia eshte 45 mph ose me pak, te pakten 300 kembe kur doni te ktheheni dhe shpejtesia eshte mbi 45 mph.

## Kthese ne drite te kuqe


Megjithese keni drite te kuqe perpara , kthesat djathtas ne shume rruge dhe kthesat majtas nga nje rruge nje kalimshe ne nje rruge tjeter nje kalimshe jane te mundeshme pasi keni ndaluar krejtesisht dhe jeluari trafikun te kaloje vec ne se ka shenje "no turn on red" ( "jo kthese ne drite te kuqe") gje qe ju ndalon ju te levizni. Ne disa shenja kthesat lejohen vetem ne shigjete jeshile.




Kalimi nga nje rruge kahore, ne rrugen dy kahore.



Kalimi nga rruga dy kahore ne nje kahore.



Kalimi nga nje rruge kalimshe, ne nje rruge tjeter kalimshe.




Kalimi nga rruga nje kahore, ne rrugen tjeter nje kahore me shume se nje rruge kalimtare.

## Nderrimi I anes

Kjo eshte gje e shpeshte dhe jo e rrezikshme. Por nje pershtypje e gabuar per levizjet e tjetrit ose kalimi shume I shpejte con ne aksident. Para sete nderrosh krahu shiko cdo gje. Fillo nga pikat e verbra, ato zona majtas e djathtas nga pas qe nuk I kap pasqyra, shih mbi shpatulla ne anen ku do kalosh. Kjo eshte vecanerisht e rëndesishme kur kalon djathtas se zona e verber aty eshte me e madhe. Per te lajmeruar te tjeret, sinjalizoni para se te levizni. Kur nderroni anen, levizni ngadale pa shpejtuar. Vazhdoni te shikoni trafikun nga te gjitha anet qe te mos futeni ne ane qe eshte e mbushur me makina. Zgjidhni kohen e duhur per te levizur dhe mbani parasysh rrjedhen e trafikut.

## Zonat e verbra

Mbrapa makine suaj, majtas e djathtas ka zona te rrezikshme gjithnje - zonat e verbra. Ne makina pa pasqyra te jashtme djathtas, zakonisht kjo zone eshte me e gjere. Kur ju levizni ne cdolloj ane, gjithnje kontrolloni zonat e verbra qe te mos perplaseni me dike tjeter pa dashur ne anen tjeter.



## Zonat e verbra te krijuara

Zona te verbra keni ne cdo rast kur shikimi juaj eshte pjeserisht I bllokuar. Kryqezime, cepa rruge, makina te perkuara, peme, ferra mund te bllokojne shikimin tuaj. Ne keto raste ecni ngadale pa hyre ne mes te rruges derisa te keni pamje te paster. Per te pare aneash e pas zonat e verbra, mbani dy duart ne timon e shikoni mbi shpatulla. Rrotullimi I trupit do rrotulloje edhe duart, ndaj ktheni vetem, koken. Levizja ne zonen e verber te dikujt tjeter eshte po aq e rrezikshme. Ose kaloni perpara ose rrini pas, por mos rrini pere shume kohe ne zonen e verber te tjetrit.


## Kalimi

Pamja e paster dhe vendimet e matura jane kyçi I kalimit me sukses. Kaloni vetem atehere kur nuk pengoni trafikun qe po vjen apo ate qe lini pas. Ne se po ju parakalon dikush ju keni gjithashtu detyrime. Asnjehere mos shkoni ne qender apo perballe makines qe po ju kalon ju. Te dyja keto manovra cojne ne aksident. Lejoni makinat e tjere t' ju kalojne e mos e rrisni shpejtesine.

### Menyra e kalimit

1. Ne rruge me me shume se dy kalime ne te njejtin kah, shihni anash dhe kontrolloni pasqyrat para se te kaloni.
2. Kontrolloni zonat tauaj te verberasinjalizoni pastaj levizni ne anen e majte.
3. Mbani te njejten shpejtesi dhe shkoni prape djathtas. vetem kur te shihni dritat e perparme te makines qe sapo kaluat ne pasqyren e pasme. Kjo do t' ju siguroje nje distance te mire me makinën qe kaluat.


### Shenjat e kalimeve



Vizat kahore.  
Ndalohet kalimi I ciles do ane pergjate vizes se verdhe.



Vizat e verdha solide ( te panderprera ) dhe te nderprera.  
Ndalohet parakalimi kur viza e panderprere gjendet nga kahja juaj e rruges.



Viza s dyfishte e verdhe e pa nderprere.  
Ndalohet parakalimi ne te dy anet kahore.

## Sigurohuni qe s' eshte e rrezikshme para se te kaloni

Kalimi majtas vizes se qendres eshte me I rrezikshmi sepse duhet te shihni edhe trafikun qe po vjen. Perplasjet me koke ndodhin tamam sepse eshte gabuar llogaritja e kohes dhe e vendit. Kur kaloni ne keto kushte, sinjalizoni dhe shikoni trafikun mire pervec zonave tuaja te verbra. Terhiquni ne se eshte e domosdoshme, ndenjtja ne rradhe eshte me pak e rrezikshme se kalimi. Vetem kur pamja eshte e lire mund te kaloni. Mos mendoni se jeni te sigurte kur arrini ne fund te nje zone ku s' ka kalime ose kur ecni ne zone qe s' eshte me vija me verdha. Kur ecni me 55 mph ju duhet te pakten 1000 kembe te stoponi, te ktheheni ne anen tuaj ose te shmangni perplasjen. Ju mund te doni 2000 kembe pamje te paster qe te manovroni lirisht.

### Parakalimi ndalohet kur jeni duke

- U afruar majes se nje kodre.
- Marre nje kthese kur pamja eshte e bllokuar per te pakten 700 kembe.
- Kaluar 100 kembe afer nje ure, tuneli apo kanali.
- Kaluar 100 kembe nga nje kryqezim apo shina treni.
- Dale nga asfalti apo nga rruga.

### Frenim - ndalim

Ajo qe ben makinën tuaj te ndaloje eshte kombinimi I peshes se makines, gjatesise, rimorkios, per masave te rrotave, presionit ne to etj. Llogarisni keto ne kohe, plus kohën qe ju duhet juve per te reaguuar e frenuar dhe ju do te keni distancën tuaj aktuale te ndalimit. Pavaresisht sa e mire eshte makina juaj apo sa I zoti jeni ju ne makine, ju s' mund te ndaloni forcat e ferkimit mes rrotave e rruges. Ne se e beni kete, timoni juaj do priset. Kjo tregon marredhenien e ngushte qe mbizoteron mes mes distances frenuese dhe kushteve te rruges. Me qe distanca stopuese ndryshon me kushtet e rruges, ju duhet te ulni shpejtesine dhe te rrisni distancën me makinat e tjera kur kushtet keqesohen.



## Ndalime te detyruara

### Ju duhet te ndaloni gjithnje ne

- Ne kryqezime shinash treni me sinjale pulsuese. Nese nje person me flamur eshte aty, prit derisa te te tregojte rugeklimin. Ne se drita e kuqe pulson dhe s' ka njeri me flamur aty, prit derisa zhduken nga pamja juaj te gjithte vagonat para se te kaloni. Nese ka vije ndaluese, ndalo para se te kalosh shinat, por kur shikon trenin qe ka kaluar dhe qe s' ka tjeter tren afer qe po vjen.
- Kur hyn ne rruge kryesore nga nje rrugice.
- Te te gjitha shenjat stop.
- Para se te kalosh nje kalim kembesoresh.
- Sa here ta kerkon kete nje polic.
- Kur sheh nje drite te kuqe qe pulson, para se te vazhdosh rrugen.
- Te cdo drite e kuqe.
- Shoferat me pasagjere brenda, autobuset e shkollave dhe kamiona me ngarkese qe mund te marre flake kollaj, te ndalojne 10 deri ne 50 kembe nga shinat e trenit para se te kalojne vec ne se ka perjashtim dhe eshte shkruar.

## Shpejtesia

Ecja shume shpejt apo shume ngadale atehere kur s' duhet eshte shkaku kryesor i aksidenteve. Ju duhet t' ja pershtatni shpejtesine tuaj fluksit te trafikut sepse shanset per te pasur aksident rriten kur ka ndryshim te madh mes shpejtesise se makines suaj dhe shpejtesise se makinave te tjera qe ecin ne rruge. Megjithate mbani mend se maksimumi i lejuar i shpejtesise eshte 55 mph. Me e mira qe mund te beni eshte te ulni shpejtesine sipas qartesise se pamjes, erresires, pengesave dhe cdo lloj pengese tjeter te mundeshme. Ecni duke mbajtur nje distance ku mund te shihni qarte para jush. Perdorni rregullen e 2 sekondave per te mbajtur nje largesi te mire mes jush dhe makines para jush. Mbani mend se frenat ndalojne vtem levizjen e rrotave, makina juaj do te vazhdoje te eci edhe pasi ju keni shkelur pedalin e frenave. Per shembull me dyfishin e shpejtesise fillestare, juve ju duhet 4 here me shume hapesire frenimi, kurse me trefishin e shpejtesise, 9 here me shume. Dhe kjo ne rast se kushtet jane te mira. Shpejtesia dhe hapesira e frenimit varen gjithashtu nga kushtet e rruges. Ju duhet te keni kontroll mbi makinën ne cdo moment. Mos ecni me 55 mph nese kushtet jane per 30 mph; limitet e shpejtesise jane maksimumet ne kohe te mire.

Kjo do te thote se ju duhet te ulni shpejtesine per te rritur sigurine, ne se eshte e nevojshme.

### Limitet per jeten tuaj

Nderkohe qe shpejtesite e medha jane vdekjeprures, shpejtesite e uleta jane te rrezikshme gjithashtu. Mos bllokoni trafikun normal duke ndryshuar papritur shpejtesine ne krahasim me te tjeret. Beni qe trafiku, rruga dhe kushtet e motit te vendosin shpejtesine tuaj brenda limiteve legale. Iowa ka limite shpejtesie qe ndryshojne ne zona te ndryshme. Ne se s' ka shenje tjeter, keto limite nuk duhen kapercyer, per hir te sigurise se te gjithëve.

### Qytet mph

Biznes	20
Banim	25
Shkolla	25
Rrethina	45
Jo kryesore ( konkrete dhe./ose asfalt )	55
Jo kryesore ( te pashtuara )	55 ( ditën ) 50 ( naten )

Nderlidhese qytetesh & rruge kryesore 55  
Nderlidhese krahinash 65 ( minimumi 40 mph ne rruge nderlidhese )

## E drejta per te parakaluar


Dritat pulsuese dhe sirenat jane shenja te sigurta te afrimit te nje urgjence ose makine policie. Ne qofte se nuk keni vize ndarese ne mes me ta, ju duhet te shkoni paralel rruges e te ndaloni - pavaresisht se ku po shkoni. Te ndjekesh nje makine urgjence me afer se 500 kembe eshte ilegale. Ne kryqezime duhet te mendosh se shoferi tjeter s' do te te lejoje te parakalosh. Por juve duhet te lini te tjeret nga e djathta juaj kur 2 ose me shume makina hyjne ne te njejten kohe nga drejtime te ndryshme. Gjithashtu lejoni trafikun qe po vjen ne se po ktheheni majtas ose po i afroheni nje shenje trekendeshi qe lejon kalimin tuaj.

Edhe nese kembesoret dhe ata ne biciklete kane rregulla te tjera, shpesh ata i harrojne ato dhe i bien rruges per shkurt perballe makinave dhe nisen neper cepat e rruges pa para per te tjeret. Makina juaj eshte si nje pushke e mbushur. Nje kembesor apo bicikletist nuk ka mbrojtje nga makina ndaj juve duhet t' u hapni rruge atyre ne cdo kohe. Me ligj ju duhet te lejoni te kalojne ne zonat e shenuara me viza te bardha, ne kryqezimet pa viza dhe te verberve qe kane shkopinje me viza bardh e kuq apo qen qe i drejton. Autobusat e shkollave nenkuptojne femije. Ne rrethina ju duhet te jeni gati per te ecur me 20 mph kur dritat pulsojne.

Ndaloni te pakten 15 kembe larg autobusit kur shoferi ka nxjerre doren jashte. Pavaresisht nga drejtimi qe keni, ju duhet gjithnje te lejoni nje autobus shkolle qe ka ndaluar me dritat e kuqe qe pulsojne dhe shoferi ka nxjerre doren jashte ne shenje stopi, vecse ne se jeni duke ecur ne anen tjetet te rruges ne nje autostrade me 2 apo me shume kalime ne secilen ane. Megjithese ligji s' e thote, eshte sjellje e mire te lejosh nje funeral dhe t' i lesh te kalojne si grup. Te hysh e te dalësh nga kalimi yt ose bllokimi i nje kryqezimi mund te cojné ne aksidente.

### Situata kur duhet te lejosh

(Makinat me shenjén "Y" yield duhet te lejohen te kalojne para ).




Automjetet ne kryqezim.




Automjeti ne te djathte.




Trafiku nga ana e kundert.



Rruga e siguruar.



Autobusi i ndaluar shkollor.



Automjetet emergjente.

### Ju duhet te lejoni te parakalojne edhe ne keto raste te diskutueshme

- Kthese majtas apo djathtas ne drite te kuqe pasi keni ndaluar.
- Ne cdo shenje per te lejuar te tjeret.
- Kur drejton rrugen nje polic.
- Kur hyni ne rruge nga nje rrugice apo rruge me e vogel.

### Ecja ne autostrade

Keto jane rruget ndrelidhese me te sigurta. Kane me pak aksidente per milje por ato qe ndodhin jane me te renda. Shumica e aksidenteve vijne nga shoferet qe s' lejojne te tjeret te kalojne ose nuk vleresojne drejt largesite ne shpejtesite e autostradave.

## Hyrja

Edhe hyrja ne nje ruge te madhe mund te jete e veshtire. Perdorni kalimin e shpejtesise per te rritur shpejtesine tuaj gradualisht, nderkohe qe sinjalizoni dhe kontrolloni trafikun per t' u futur ne nje te care qe mund te gjeni. Ne se ka makina para jush, kontrollo ne se shoferi ndalon papritur. Levizjet e papritura shkaktojne perplasje. Kalimet e shpejtesise qe jane te shkurtera, mund te japin probleme. Ne keto raste shikoni per te cara te medha ne trafik, prisni me gjate dhe shpejtoni me shume. Kur ju jeni ne autostrade, kontrolloni te tjeret. Ju duhet te pershtasni shpejtesine ne pershtatje me trafikun dhe kushtet e motit. Ecja me shpejt ose me ngadale se te tjeret, rrit shanset per perplasje. Megjithate, mos u ngjishni shume pas makinave te tjera. Largesia e vogel s' ju le rrugedalje ne rast urgjence. Shpejtesia maksimale ne autostrade eshte 55 mph per te gjitha makinat. Me kete shpejtesi nje makine qe eshte pas jush, mund te hyje me shpejtesi ne zonen tuaj te verber pak sekonda pasi ju e keni kontrolluar ate. Para se te nderroni anen tuaj shikoni zonen tuaj te verber dhe anen ku po hyni per te qene te sigurte qe asnje s' do ju pengoje gjate kesaj manovre.

## Cila linje eshte me e mira?

Pergjithesisht, mbani anen e djathte te rruges dhe parakaloni majtas. Por ne rruget me tre kalime, perdorni kalimin djathtas per shpejtesite me te uleta, te mesit per shpejtesi normale dhe te majtin per te parakaluar. Ne se ju rrimi ne anen e djathte, shihni makinat qe po hyjne ne rruge nga kalimi i shpejte per t' u lene kohe te pershtaten ne trafik duke rregulluar shpejtesine tuaj ose duke me shi, bore ose kushte te tjera qe pengojne shikimin shihni per reflektore ose viza udhezuese. Reflektoret e bardhe vihen gjate kalimit. Keto zakonisht vihen djathtas dhe nganjehere edhe majtas 250 kembe larg nga njeri - tjetri. Reflektoret e verdhe vihen aty ku ka kthesa, sa me e forte kthesa aq me afer vihen reflektoret. Reflektoret e dyfishte tregojne zonat e rritjes apo te uljes se shpejtesise. Te dy llojet, te bardhe e te verdhe vihen ne rruget qe vine duke u ngushtuar.

## Jashte rruges

Perdorni vizat e rruges per te dale jashte autostrades, gje qe mund te jete me probleme. Gati 1 milje para se te hyni ne exit ( dalje ), shikoni djathtas dhe shihni per anen ku ulet shpejtesia. Kjo mund te jete nje rruge e gjate tamam jashte autostrades, ne njete shkurter qe shkon drejt e ne dalje. Ngadalesoni ne dalje aq sa e lejojne rrethanat per te levizur me siguri, shkeli frenat vetem ne anen e daljes.

Perdorimi i vizave te rruges per te lene autostraden e ben me te lehte levizjen si per ju edhe per te tjeret, pasi i le ate te kuptojne se ku po shkon. Nje reflektor i dyfishte tregon ku po fillon apo mbaron rruga dalese. Kur ju shihni vizen qe tregon dalje, ju duhet te pergatiteni per nje kthese ose ndryshim te shpejtesise. Parapergatitja eshte kyçi i sigurte i mbijeteses. Ne se e kaluat pa dashur daljen tuaj, mos u ktheni mbrapsht as mos ndaloni se do beni aksident. Vazhdoni drej ne daljen tjetere.

## Ndalimet ne urgjence

Kur shihni probleme qe me para ne rruge, ju jep kohe juve te manovroni dhe paralajmeron shoferet e tjere pas jush. Ne se duhet te frenoni per nje urgjence, sinjalizoni, dhe dilni krejt anash rruges. Ndzini 4 dritat e urgjences dhe ngrini antenen apo kapakun e makines me nje flamur te bardhe ne te. Ne se ju shihni nje makine tjetere qe rri anash rruges, kaloni nga majtas nese keni mundesi. Shoferi mund te mos ju kete para ju dhe mund te hyje ne rruge menjehere para jush.

## Ecja ne kohe te keqe

Ne se ju keni ecur gjithnje ne dite te mira, ju nuk do keni probleme per kushtet e trafikut. Por nuk eshte keshtu. Ne kohe te keqe, duhet te ndryshojne edhe zakonet tuaja te ecjes. Kjo ju kompenson ju per pamjen e keqe qe do keni dhe kohen e reagimit.

## Ecja naten

Eshte gje e bukur te ecesh naten me makine - yjet ndricojne, filladi hyn permes dritares se hapur - dhe eshte gje e rrezikshme. Statistikat tregojne se aksidentet naten jane 2 here e gjysme me te shpeshta se ato ditet. Ju mund te jeni me te sigurte nese mbani parasysh se udhetim naten do te thote pamje e ulur. Perdorni dritat e perparme qe nga perendimi i diellit e deri ne agim kur pamja e lire para jush shkon deri ne 500 feet ( kembe ) ose edhe me pak. Per te zvogeluar problemet, ndriconi me dritat e sinjaleve 500 feet ( kembe ) nga nje makine qe po afrihet dhe 200 feet ( kembe ) kur jeni pas nje makine tjetere. Ne se keni te beni me nje shofer kokeforte qe nuk perdor dritat per te sinjalizuar, e mira eshte te shihni vizat e bardha dhe te ulni shpejtesine. Ndricimi i dritave te tjetrit mund t' ju verboje per pak sekonda ju, ndaj ju duhet kohe per te rimarre veten. Me kalimin e moshes do t' ju duhet me shume kohe te merrni veten. Pajisjet e ndotura e ulin edhe me shume pamjen e lire naten. Dritaret e ndotura duken me shume naten duke erresuar rrugen, shenjat dhe levizjet e te tjereve. Ne erresire ju s' mund te shihni a keni ndonje problem para jush ne rruge vecse

kur keni arritur aty. Kjo ju le distance te vogel frenimi. Per te pasur me shume shanse, naten ecni me ngadale qe te keni kohe te reagoni. Ecja me shpejtesi naten do te coje ne "ecje me koke" qe do te thote distanca juaj e frenimit eshte me e madhe se distanca qe mund te shihni ju.

### **Mjegulla**

Gjeja me e mire n mjegull eshte temos levizni fare. Ne se keni mundesi, dilni jashte rruge dhe prisni. Ne se jo, ulni shpejtesine. Ulni shpejtesine edhe nese shihni dritat para jush. Ato mund te jene te dikujt qe gabimisht po afrohet ne anen tuaj ose nje makine qe ka ndaluar para jush. Gjithsesi me pamjen dhe perceptimin tuaj te ulur ju duhet te lini kohe per te reaguar ose ndaluar. Ecja ne mejgull te dendur eshte me e keqe se ecja naten. Per shkak se lageshtia eshte aq e madhe ne ajer, dritat tuaja do te reflektohen mbrapsht ne syte tuaj. Dritat e uleta qe zakonisht drejtojne ndricimin poshte ne rruge jane me te rekomanduara. Shihni per anet e rruges per t' u orientuar.

### **Shiu**

Shume veta nuk ecin ne shi, ate shkasin Rrotat e amkinave te tyre rralle cikin token. Kjo quhet hidroplaning - nje nga rreziqet me te medha ne shi. Fillon ne afro 35 mph e rritet deri ne 55 mph kur rrotat tuaja do te jene krejtesisht ne uje. Pra, s' ka ferkim te forte, ulet efekti i frenimit dhe gati zhduket eficiensa e timonit. E vetmja gje qe mund te beni eshte te vazhdoni rrugen . Zakonisht hidroplaning zgjat vetem per pak. Mbani rrotat drejt ose shkoni drejt rruges ku doni te vazhdoni. Menyra me e mire per te kundervepruar ndaj hidroplaning eshte ta prandalosh ate. Gjithnje kontrolloni gomat a kane difekte dhe a jane fryre mire. Edhe nese gomat tuaja jane te shkelqyera, mos l vur ne prove duke ecur shpejt permes shiut e pellgjeve. Shpejtesite e medha e bejne ecjen ne shi edhe me te rrezikshme. Hidroplaning tregon sa e rendesishme eshte mirembajtja e rrotave tuaja. Rrotat e dobeta do rreshqasin. Shume aksidente ndodhin ne minutat e para te furtunave. Vaji l rruges perzihet me ujin per te krijuar nje siperfaqe shume te rreshqiteshme. Ferkimi eshte gati zero dhe distanca e frenimit rritet gati 40%. Rrisni distancen nga makina para jush dhe ulni shpejtesine. Nga vendi ku jeni ju te gjitha pellgjet e ujit duken njelloj por mos l zini bese. Nese keni mundesi shkoni anash pellgut per te shmangur surprizat si nje aks l thyer sepse pellgu l "vogel" qe nje vrime 6 inc.

### **Bora dhe ngricat**

Dimri ne lowa eshte l paparashikueshem, me e pakta qe mund te thuhet dhe do aftesi te medha ecjeje ne makine. Gjeja e pare qe ju duhet ne bore eshte ferkimi. Gomat e bores ose zinxhoret jane te rekomandueshem. Ju mund te perdorni perforcime per gomat duke filluar nga 1 nentori deri ne 1 prill. Gomat radiale dhe ato joradiale nuk duhen perziere. Rreziku l rreshqitjes eshte me l madh kur ju keni goma bore radiale para dhe joradiale pas. Ne se gomat e para jane radiale edhe te pasmet duhet te jene radiale. Ndalimi dhe fillimi l levizjes ne bore mund te te ngrijne gjakun. Sidoqofte, mos u bjer me force frenave se ndryshe do te bllokosh rrotat. Perdorni frenat ne menyre qe rrotat te mund te levizin kollaj e t' ju nxjerrin nga rreshqitja. Kur hyni ne rruge, kujdes kur l jepni gas makines se mund te ngecni ne debore. Nese ngecni, mbani timonin drejt dhe jepini para e mbrapa. Ferkimi me l madh fillon tamam para se rrotat te rrotullohen. Ngaqe ferkimi eshte l kufizuar, distanca e frenimit rritet. Ngadalesoni dhe rrisni distancen me makinen perpara. Pllaka akulli te fshehta ne ura dhe vende te tjera te hapura mund t' ju nxjerrin ju nga rruga sidomos ne kthesa. Gjithnje kthehuni ngadale menjanhuni nese eshte e nevojshme - per te shmangur rrutullimet ose rreshqitjet. Nese rreshqisni, mos l jepni shume gas makines dhe veproni ne menyre te tille qe fundi l makines te levizi. Temperaturat e dimrit shkojne lart e poshte, ndaj akulli ngrin e shkrin shpesh duke veshtiresuar ecjen. Akulli i shkrire ne 32\* F eshte dyfish me l rreshqitshem se akulli ngrire. Edhe nese temperatura ngrohet shume, mos u nxitoni. Rruga mund te mos kete akull, por era qe fryn poshte urave, ben qe te ngrije rruge serish. Mbani nje mjet per te gerryer boren dhe po mundet nje lopate te vogel per bore qe te pastroni rrugen shpejt. Shkrirja e bores mbi drita nuk ndihmon, ndaj mbajini te pastra ato. Ne se keni nje shkrirese perdoreni keshtu nuk do mbeteni me xhame me avull dhe me nje rrip te ngushte shikimi perjashte. Ndryshe, hapni dritaren dhe barazoni temperaturat brenda e jashte. Mos hapni makinen kur jeni te rrethuar nga bora, ajo krijon xhepa me monoksid karboni qe mund te depertojne brenda makines suaj dhe t' ju mbysin ju.

## **Levizjet kur jeni I intoksikuar apo I droguar**

Iowa ka ligje te rrepta kunder ecjes se shofereve qe kane pire alkohol ose jane droguar. Ligji OWI (operating while intoxicated ) thote qe eshte e denueshme te udhetosh kure ke pire alkohol, droge apo kombinim te tyre. Iowa ka edhe nje ligj tjeter qe lejon cdo oficer te kerkoje nje test te frymarjes, urines ose gjakut nese atij I dukeni ju si I pire apo I droguar. Ky ligj vlen njejte si per banoret dhe jobanoret dhe e e lowes.

### **Ligji per kanoce ( pije alkoholike ) te hapur**

Eshte e denueshme nga ligji ne Iowa te udhetoni me nje kanoce birre te hapur ne makine ose pije tjeter nese:

- Kanocja e hapur e pijes eshte ne anen e pasagjereve e cgo makine apo kamioni.
- Kjo kanoce eshte e mundur te arrihet nga shoferi po te zgjasi doren. Denimi per thyerjen e ketij ligji eshte 1000 dollare gjobe dhe/ose burg per nje vit.

**Ligji per kanoce ( pije alkoholike ) te hapur**  
Eshte e denueshme nga ligji ne Iowa te udhetoni me nje kanoce birre te hapur ne makine ose pije tjeter nese:

- Kanocja e hapur e pijes eshte ne anen e pasagjereve e cdo makine apo kamioni.
- Kjo kanoce eshte e mundur te arrihet nga shoferi po te zgjasi doren. Denimi per thyerjen e ketij ligji eshte 1000 dollare gjobe dhe/ose burg per nje vit.